

FTESË PËR OFERTË

Emri: Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Familjes
Adresa: Rr. Loni Ligori, Kompleksi ILAD, Kulla 3, Ap.10, Tiranë
E-mail: infoacfdalbania@gmail.com
Afati i dorëzimit të ofertës: **12 Shkurt 2024**

Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Familjes po zbaton projektin ‘Vlerëso-Fuqizo-Vepro: stafe sociale më të fuqizuara përballë shërbimeve të kujdesit social, për fëmijët me AK, në Bashkinë Kavajë’, në kuadër të Programit Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Prendimor 2 (ReLOaD2), i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), duke mbështetur bashkitë në zhvillimin e mekanizmave transparente të financimit për OSHC-të, në mënyrë që të përmirësojnë ofrimin e shërbimeve për qytetarët në komunitetin lokal. Në kuadër të zbatimit të këtij projekti organizata kërkon të organizojë një aktivitet për fëmijët me AK, ku këta të fundit do të përfitojnë zhvillimin e tyre mental duke përdorur mjete didaktike. Në këtë mënyrë ne na nevojitet një subjekt që ofron këto mjete didaktike të nevojshme për fëmijët me AK.

Kushtet për pjesëmarrje:

Të gjithë subjektet e interesuara duhet të dorëzojnë ofertën e tyre sikurse parashikohet në kushtet e përgjithshme dhe specifike të kësaj ftese deri më **12/02/2024**, në adresën e e-mailit: infoacfdalbania@gmail.com ose në adresën postare Rr. Loni Ligori, Kompleksi ILAD, Kulla 3, Ap.10, Tiranë

Specifikimet teknike:

Për këtë projekt, Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Familjes do të zhvillojë procedurën e prokurimit për produktet dhe shërbimet sipas përshkrimeve në tabelën e mëposhtme.

Nr	Përshkrimi i mallit/shërbimit/	Çmimi/njësi Me TVSH
1.	Mjete didaktike për fëmijët me AK (libra me veprimtari për përgjithësimin e njohurive/printer me ngjyra së bashku me toner-at përkatës/kafshë 3D/libra me audio/kartona me ngjyra dhe të bardhë/bojra akreliku/libra me ngjyrosje/fletëpunëdore me xixa dhe	

	ngjitëse/plastelinë/kanavaca/mjete muzikore për fëmijë/dollapë për mbajtjen e mjeteve)	
--	--	--

Specifikime të përgjithshme teknike:

Mjetet didaktike të llojeve të ndryshme janë specifikuar si më poshtë:

- 1) *Libra me veprimtari për përgjithsimin e njohurive (16 copë). Librat mund të jenë nga shtëpi botuese të ndryshme, por duhet të kenë të bëjnë me tematika që lidhen me mësimin e numrave, shkronjave, ngjyrave, stinëve, kalendarin, etj..*
- 2) *Printer me ngjyra (1 copë) së bashku me toner-at përkatës, printeri preferohet i markës HP, Laser MFP color 178nw, multifunksional, 21 ppm dhe shoqëruar me tonerat përkatës;*
- 3) *Kafshë 3D (17 pako) kafshët janë lodra në përmasa të vogla dhe me material gome që nuk i dëmtojnë fëmijët;*
- 4) *Libra me audio (16 copë) librat me audio mund të jenë nga shtëpi botuese të ndryshme, por duhet të përmbajnë këto tematika: (numrat, alfabeti, kafshët, automjetet) gjithashtu të jenë libra me audio që përmbajnë përralla të ndryshme për fëmijë;*
- 5) *Kartona me ngjyra dhe të bardhë (45 copë nga secili, në total 90 copë), kartonat do të jenë në përmasat 70:100, ngjyra të ndryshme (e kuqe, e verdhë, jeshile, blu, kafe, e zezë, e bardhë, lejla, rozë, etj);*
- 6) *Bojra akreliku (19 pako), preferohet set bojrash akreliku, 12 copë me 7.5 ml secili nga tubetat e bojës. Seti do të përfshijë ngjyrat bazë dhe më të përdorshme (e kuqe, blu, e verdhë, jeshile, e bardhë, e zezë, kafe, etj);*
- 7) *Libra me ngjyrosje (30 copë) librat do të përmbajnë figura që do të ngjyrosen nga fëmijët si p.sh (kafshët e fermës, frutat, perimet, automjetet, etj);*
- 8) *Fletëpunëdore me xixa dhe ngjitëse (16 pako), pakoja do të përmbajë 10 letra me ngjyra të ndryshme me përmasë A4, materiali i letrës do të jetë i gomuar dhe me efekt xixash gjithashtu të ketë mundësi që të ngjitet pasi të pritët;*
- 9) *Plastelinë (16 pako), pakoja do të jetë 180 gr dhe do të përmbajë 10 ngjyra (e bardhë, e verdhë, portokalli, e kuqe, jeshile, lejla, kafe, rozë, e zezë, blu)*
- 10) *Kanavaca (5 copë) këtu do të përfshihen 5 kavaleta pikturë të vogla 36 cm dhe 5 telajo me përmasa 25x35.*
- 11) *Instrumenta muzikore për fëmijë (16 copë) instrumentat do të jenë lodra (fyell, piano, tamburin dhe drum);*
- 12) *Dollapë për mbajtjen e mjeteve (1 copë), dollapi do të ketë material prej druri, do të jetë i mbyllur dhe do të ketë disa raftë, përmasat do të jenë afërsisht 80x35x220.*

Në ofertën që do të dorëzoni përfshini edhe listën e librave që dispononi për pikën 1 dhe 6. Produktete ofruara duhet të jenë cilësore dhe t'i përshtaten specifikimeve të përshkruara më lartë.

Ofrimi i këtyre produkteve kërkohet për periudhën 15 Shkurt 2024 – 23 Mars 2024. Datat specifike do të përcaktohen në kontratën e lidhur me subjektin fitues

Kushte të përgjithshme:

- 1) Subjektet duhet të jenë të regjistruar dhe licensuar rregullisht me objekt veprimtarie shërbimet e kërkuara;



- 2) Preferohen subjekte të regjistruar me aktivitet në territorin e bashkisë Kavajë;
- 3) Dorëzimi i ofertës do të bëhet vetëm nëpërmjet email në adresën e organizatës infoacfdalbania@gmail.com brenda datës 12/02/2024 ose në adresën postare Rr. Loni Ligori, Kompleksi ILAD, Kulla 3, Ap.10, Tiranë.

Nuk pranohen ofertat dorazi.

- 4) PAGESA E SUBJEKTTIT KRYHET ME TRANSFERTË BANKARE PAS MARRJES SË SHËRBIMIT DHE LËSHIMIT TË FATURËS PËRKATËSE.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit. Gjithashtu ofertuesit, krahas Ofertës financiare të plotësuar, e cila duhet të jetë në ALL (LEKE) dhe TVSH-ja të përfshihet në kosto/çmim, duhet të paraqesin edhe këto dokumenta:

- 1) Licencën për ushtrimin e aktivitetit (NIPT);
- 2) Ofertën financiare për çdo produkt sipas tabelës më sipër.
- 3) Numrin e llogarisë bankare.

Operatori që ofron produktet me çmimin më të ulët dhe në përputhje me specifikimet teknike sipas ftesës, do të njoftohet për të nënshkruar kontratën.

